



Duke u bazuar në nenin 12 paragrafi 2 shkronja d) nenin 17 shkronja a) dhe nenin 40 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nr.03/L-040, publikuar në Gazetën Zyrtare, nr.28/2008, nenin 5. Nenin 6 paragrafi 1 pika 1.1 të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, nr.06/L-092 publikuar në Gazetën Zyrtare, nr.10/2019, nenin 5 paragrafi 1 paragrafi 1 pika 1.2 nenit 6, 8 dhe 17 të Rregullores së QRK-së nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, si dhe nenin 10 dhe 40 të Statutit të Komunës së Klinës, nr.01-110-1232/2010 të miratuar më datën 31.03.2010, me propozimin e kryetarit i Komunës së Klinës, kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e rregullt të mbajtur me datë 22.09.2023 mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet propozim-vendimi i kryetarit të komunës me **Nr.01-361-33449/2023** dhe merret vendimi paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër për periudhën 10 vjeçare të pronave të paluajtshme të komunës së Klinës- lokaleve afariste, të përcaktuara sipas njësive, si në piken 2 të këtij vendimi.
2. Lokalet afariste në pronësi të Komunës së Klinës, të cilat gjinden në ZK Klinë, të ndërtuara në parcelat, **nr.537-2** dhe **443-53**, e të cilat do të jepen në shfrytëzim afatshkurtër përmes procedurës së ankandit publik, janë gjithsejtë **23** lokale, si në vijim:

• Në objektin Nojtra,

1. lokali më numër të njësive 537-2-1-0-35-0 më sipërfaqe prej **23 m²** kati 3;
2. lokali më numër të njësive 537-2-1-0-49-0 më sipërfaqe prej **23 m²** kati 4;
3. lokali më numër të njësive 537-2-1-0-62-0 më sipërfaqe prej **32 m²** kati 4;
4. lokali më numër të njësive 537-2-1-1-26-0 më sipërfaqe prej **32 m²** kati 3;
5. lokali më numër të njësive 537-2-1-1-27-0 më sipërfaqe prej **16 m²** kati 3;
6. lokali më numër të njësive 537-2-1-1-28-0 më sipërfaqe prej **27 m²** kati 3;
7. lokali më numër të njësive 537-2-1-1-29-0 më sipërfaqe prej **22 m²** kati 3;
8. lokali më numër të njësive 537-2-1-1-30-0 më sipërfaqe prej **28 m²** kati 3;
9. lokali më numër të njësive 537-2-1-1-31-0 më sipërfaqe prej **22 m²** kati 3;
10. lokali më numër të njësive 537-2-1-1-32-0 më sipërfaqe prej **27 m²** kati 3;
11. lokali më numër të njësive 537-2-1-1-33-0 më sipërfaqe prej **32 m²** kati 3;
12. lokali më numër të njësive 537-2-1-1-34-0 më sipërfaqe prej **19 m²** kati 3;
13. lokali më numër të njësive 537-2-1-1-35-0 më sipërfaqe prej **20 m²** kati 4;
14. lokali më numër të njësive 537-2-1-1-36-0 më sipërfaqe prej **16 m²** kati 4;
15. lokali më numër të njësive 537-2-1-1-37-0 më sipërfaqe prej **27 m²** kati 4;
16. lokali më numër të njësive 537-2-1-1-38-0 më sipërfaqe prej **22 m²** kati 4;
17. lokali më numër të njësive 537-2-1-1-39-0 më sipërfaqe prej **28 m²** kati 4;
18. lokali më numër të njësive 537-2-1-1-41-0 më sipërfaqe prej **27 m²** kati 4;
19. lokali më numër të njësive 537-2-1-1-42-0 më sipërfaqe prej **32 m²** kati 4;
20. lokali më numër të njësive 537-2-1-1-43-0 më sipërfaqe prej **19 m²** kati 4;

• Ndërsa në objektin Mirusha,

1. lokali më numër të njësive 443-53-4-2-8-0 më sipërfaqe prej **52 m²** kati P;
2. lokali më numër të njësive 443-53-4-2-12-0 më sipërfaqe prej **47 m²** kati 1;
3. lokali më numër të njësive 443-53-4-2-13-0 më sipërfaqe prej **52 m²** kati 1;

3. Qëllimi i dhënies i dhënies në shfrytëzim i pronës së paluajtshme të komunës të cekura si në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi, është ruajtja dhe rritja e vlerës së pronës publike komunale si dhe rritja e zhvillimit ekonomik. Lokalet janë të përfshira në listën e veçantë për dhënie në shfrytëzim e cila liste është miratuar më vendim nga ana e Kuvendit të Komunës së Klinës, si dhe është publikuar në ueb faqen zyrtare të Komunës së Klinës më qëllimin e zhvillimit të proceduarve të dhënies në shfrytëzim këtë vit.
4. Afati kohorë për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim, të cekur si në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi është afatshkurtër në periudhën prej 10 vite.
5. Komuna e Klinës e ruan të drejtën kurdoherë që sipas nevojës, për realizimin e interesave publike të komunës të ndryshoj kontratën me përfituesin e pronës së dhënë në shfrytëzim.
6. Pronat e paluajtshme në fjalë nuk e ndërrojnë titullarin juridik, pronar i tyre mbetet Komuna e Klinës dhe si e tillë ajo nuk mund t'i jepet personit të tretë në shfrytëzim nga ana e shfrytëzuesit.
7. Çmimi pronave të lartcekura si në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi behet mbi baza mujore, përcaktohet nga komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës sipas vlerës së përcaktuar me dispozitat ligjore në fuqi.
8. Obligohet Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrotjtje të Mjedisit dhe Zyra e Prokurimit që në bashkëpunim me komisionin për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës të zhvilloj procedurat e ankandit publik në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-092 dhe Rregulloren (QRK) Nr. 09/2020.
9. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Klinës së Klinës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës (MAPL) në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale dhe nenit 8 lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes në web-faqe zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- **Kryetari i Komunës,**
- **MAPL,**
- **Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi**
- **Zyra për Informim**

KUVENDI I KOMUNËS KLINË

01Nr. 06-39057 2023
Klinë: 28.09 2023



**Kryesuesi,
Fadil Gashi**